

DITARI MUJOR KORRIK 2024

MONUMENTET E DËMTUARA GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore organizoi ekspozitën “Monumentet e Dëmtuara gjatë Luftës së Dytë Botërore”.



Qëllimi i kësaj ekspozite ishte të rikujtojë dhe të prezantojë objektet e dëmtuara gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, përmes një koleksioni të vlerësuar të materialeve grafike dhe dokumenteve arkivore, të cilat janë të rëndësishme për historinë e vendit tonë.



Shprehim mirënjohjen tonë për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit Shtetëror për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre në mbledhjen e materialeve arkivore, si dhe ekspertë të fushës që morën pjesë në këtë ekspozitë për të ndarë eksperiencën e tyre disa vjeçare mbi historikun e Monumenteve të Kulturës në Shqipëri.

PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA



Përgjatë muajit Qershor, një ekip arkeologësh dhe restauratorësh të D.R.T.K - Vlorë, u angazhuan në gërmime arkeologjike, si dhe zbulimin e një varri tjetër monumental në hyrje të territorit të Parkut Arkeologjik të Amantias, varr i cili ndodhet në buzë të rrugës që lidh fshatrat Ploçë dhe Amonicë (Bashkia Selenicë).

Ekzistenca e këtij varri, është pretenduar gjatë gërmimeve arkeologjike të shpëtimit të realizuara nga D.R.T.K - Vlorë dhe D.SH.A/IKTK, në vitin 2020, ku në atë vit, u zbulua varri i parë monumental në atë territor.

Duke qenë se, monumenti kishte nevojë për ndërhyrje restauruese, hapje të plotë të sipërfaqes për të mundësuar drenazhimin e ujrave që po e dëmtonin, si dhe studimin dhe dokumentimin e tij, me vendim të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, u miratuan dhe realizuan, ndërhyrjet e domosdoshme të sipërpërmendura.

Nga elementet e tjerë të zbuluar, tërheq vëmendjen suvatimi i hapsirës së brendshme të dhomës së varrimit. Objektet e zbuluara janë kryesisht enë qeramike të fragmentuara, pak enë të plota, enë qelqi të fragmentuara, si dhe objekte metalike, ku një pjesë e madhe përbëhet nga gozhdë.

Përreth varrit monumental, u gjetën dhe dokumentuan edhe varre të tjera me tjegulla, të së njëjtës periudhë. Krahas masave paraprake të konservimit, specialistët e D.R.T.K - Vlorë po hartojnë edhe një projekt restaurimi dhe muzealizimi për monumentin.



ARKEOLOGJIA NËNUJORE

Gendra Ndërkombëtare e Arkeologjisë Nënujore në Zadar të Kroacisë (ICUA-Zadar) mbështetur nga UNESCO, organizoi kursin bazë të Arkeologjisë Nënujore 2024, në të cilin mori pjesë dhe përfaqësuesi i IKTK-së.

Kursi kishte për qëllim trajnimin e arkeologëve në teknikat e gërmimit, dokumentimit, përdorimin e paisjeve për mbarëvajtjen e gërmimit nënujor, vëzhgimin arkeologjik nënujor, përdorimin e paisjeve të zhytjes. Po ashtu u mbajtën leksione mbi konservimin dhe restaurimin e gjetjeve të dala nga thellësia e detit, hapat që ndiqen në përgatitjen e një gërmimi arkeologjik nënujor, metodat e ndryshme të kërkimit si dhe mënyrave të mbrojtjes dhe promovimit të gjetjeve kaq unike.

Gjatë kursit u zhvillua dhe një gërmim i mirëfilltë nënujor në të cilin sipas të dhënave paraprake rezultoi të ishte struktura e një porti të periudhës romake.

Në përfundim të trajnimit pjesëmarrësit u certifikuan për njohuritë bazë të Arkeologjisë Nënujore. Kjo eksperiencë do të shërbejë për zhvillimin e Arkeologjisë Nënujore në Shqipëri.

XHAMIA E PLUMBIT

Xhamia e Plumbit është ndërtuar në vitet 1773-1774 nga Mehmet Pashë Bushatliu. Ajo ndodhet në luginën që fle poshtë Kalasë së Rozafës dhe përfaqëson të vetmin monument kulturi të periudhës osmane në këtë zonë të Shqipërisë.

Minareja u rrëzua në vitin 1967 si rrjedhojë e goditjes së një rrufeje. Xhamia e Plumbit iu rikthye komunitetit fetar mysliman dhe besimtarëve pas ndryshimeve politike të vitit 1990.

Në kuadër të restaurimit dhe konservimit të objektit, ndërhyrjet konsistojnë në:

- Konsolidimi dhe përforcimi i strukturës së objektit;
- Hidroizolimi dhe realizimi i veshjes me plumb i kupolave dhe qemerëve;
- Restaurimi i elementëve dekorativ si kolonat dhe kapitelet të pozicionuara në portikun e xhamisë, etj;
- Ringritja e minares;
- Përforcimi i themeleve dhe realizimi i sistemit të drenazhit;
- Rikualifikim dhe restaurimi i zonës së mbrojtur të monumentit.

Financues i projektit: TIKA



VENDIM PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCAVE

Lajm i mirë për profesionistët që licencohen në fushën e Pasurisë Kulturore & Arkeologjisë, arrin të zgjidhet dhe problematika në lidhje me Vendimin e Licencimeve.

U përditesuan elementët e dalluar (sigla) në formatin e kartonit të licensave, nga ku i hapim rrugë ecurisë së mëtejshme për pajisjen me licensa për individët dhe subjektet.



KKTKM në mbledhjen e datës 13.06.2024 ka marrë Vendimin nr. 179 "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 394, datë 06.11.2020 të KKTKM", Për "Miratimin e formatit të licensave për individë/person fizik/person juridik për veprimtari në fushën e Trashëgimisë Kulturore".

AKT-MARRËVESHJE

MES IKTK & CNRS

Rinovohet për herë të dytë marrëveshja ndërmjet Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Qendrës Kombëtare të Kërkimit Shkencor (CNRS), për projektin “Inventari i Mozaikëve në Shqipëri”.

Site të ndryshëm janë bërë tashmë objekt studimesh dhe restaurimesh të përbashkëta, ndërmjet vitit 2013 dhe 2022, si:

- Butrinti
- Kishat e via Egnatia
- Bylis

Mozaikë të tjerë mbeten për tu studiuar, kryesisht në Butrint extra-muros, Sarandë, Durrës, Korçë ..., pa harruar dyshemetë e kishave mesjetare dhe zbulime të reja të mundshme.



INAUGURIMI I MUZEUT ETNOGRAFIK TË KRUIJËS



Muzeu Etnografik i Krujës është rigjallëruar plotësisht dhe tashmë është i hapur për publikun! Ia kemi kthyer Krujës këtë thesar arkitekturor dhe atraksion turistik, falë programit EU4Culture, financuar nga BE dhe zbatuar nga UNOPS.

I vendosur në rezidencën historike të familjes Toptani, e ndërtuar në vitin 1764, ky muze shfaq trashëgiminë e pasur kulturore të Shqipërisë. Me mbi 3000 artefakte të ekspozuara, vizitorët mund të eksplorojnë mënyrat tradicionale të jetesës së shqiptarëve dhe zakonet e tyre gjatë shekujve.

Qendra Muzeore Krujë, ku përfshihet Muzeu i Gjergj Kastriotit dhe Muzeu Etnografik, ka shënuar rekorde vizitueshmërie me 75 mijë vizitorë në periudhën Janar-Qershor 2024

Si pjesë e angazhimit tonë për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, projekti jo vetëm që restauron muzeun, por gjithashtu rrit ofertën e tij me teknologji moderne, duke përfshirë realitetin virtual dhe ekspozitat interaktive.



KOMITETI I TRASHËGIMISË BOTËRORE I UNESCO

Mbledhur në Sesionin e 46-të të tij në New Delhi, Indi, miratoi dy vendimet që kishte në rendin e ditës për qendrat e Trashëgimisë Botërore shqiptare të Butrintit dhe Berat-Gjirokastrës. Projektvendimi për Rajonin e Liqenit të Ohrit, pavarësisht se u shpall para pak ditësh nga Qendra e Trashëgimisë Botërore, është planifikuar për tu diskutuar në sesionin e vitit të ardhshëm.





MEKI, si përfaqësuese e shtetit tonë palë, mbështeti pa asnjë rezervë projektvendimet e Qendrës së Trashëgimisë Botërore dhe Komiteti i TB sapo zyrtarizoi një qendrim unanim. Ndihe mi veçanërisht të kënaqur si për vlerësimet direkte që kemi marrë në takimet me përfaqësuesit e lartë të Qendrës së TB, ashtu edhe nga ato të shprehura në vendime e sotme. Fakti që në 90% të pikave përmbajtësore të vendimit për Butrintin mirëpritën dhe mbështeten veprimet e shtetit palë është shumë inkurajuese. MEKI ka dërguar në Paris paketën e parë të hartave dhe ka marrë komentet paraprake nga Qendra e TB. Grupi teknik i punës po e ndjek me ritëm të lartë këtë detyrë që do ta plotësojmë sipas një kalendarit të dakordësuar me UNESCO.



PROJEKTE RESTAURIMI

Ura e Bunës është Monument Kulture i Kategorisë së dytë (II), datë 17.05.2010. U ndërtua me fondet e Qeverisë Turke në vitin 1889. Ndërtimi i saj u bë i mundur në sajë të iniciativës së guvernatorit të Shkodrës, Qazim Pasha. Për ndërtimin e Urës së Bunës u përdorën këmbë çimentoje të lidhura me trarë hekuri, si dhe dërrasa për shtrimin e pjesës së sipërme të saj. Në vitin 2017 ura është restauruar, duke ndryshuar shtresën me dërrasa dhe lysterjen e strukturës metalike. Pavarësisht ndërhyrjeve të kryera në vitin 2017, Ura e Bunës ka nevojë për ndërhyrje të tjera, të cilat do të konsistojnë në:

- Zëvendësimin e të gjitha dërrasave në shtresën e sipërme të urës
- Lysterje me vaj lini dhe antimol i të gjitha materialeve drusore





Kisha e Shën e Premtes (ndërtuar më 1776), është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së parë (I) në vitin 1963 dhe ndodhet në Zonën e Mbrojtur të Qendrës Historike të qytetit të Përmetit. Në vitin 1964, Kisha e Shën e Premtes është përmblytur prej përroit që kalon aty pranë. Punimet për kullimin e ujërave filluan në vitin 1967. Më pas u restaurua narteksi dhe naosi. Gjithashtu muralet e kishës janë restauruar edhe në vitet 1981-1982.

Në kuadër të projektit për restaurimin e Kishës së Shën Premtes, janë propozuar ndërhyrje në strukturë si më poshtë:

- Ndërhyrje në çati
- Muratura
- Dyshemeja
- Dyert dhe Dritaret
- Bojatisje
- Sisteme të jashtme



PROJEKTE RESTAURIMI





Kisha e Kabashit, në fshatin Kabash të Pukës, është pasuri kulturore me status Monument Kulture i Kategorisë së parë (I), datë 05.11.1984. Kisha mendohet të jetë ndërtuar në fundin e shek. XIX. Inspektimi i fundit në objekt është realizuar në prill 2024, nga specialistët e DRTK Shkodër, për të njohur nga afër problematikat që ky objekt kulti shfaq, si dhe të dhënë një panoramë të qartë të gjendjes aktuale.

Struktura në gjendje rrënoje e kishës së Kabashit ruhet në gjendje të mirë, por ka nevojë për një ndërhyrje konsoliduese dhe mirëmbajtëse.

- Pastrim i rrënjëve dhe bimësisë përreth e në lartësi të muraturës
- Konsolidim i gurëve dhe kreut të muraturës
- Restaurim i murit dhe injektim

Manastiri i Shën Juditës dhe Qirjakut, është Monument Kulture i Kategorisë së parë (I), datë 10.06.1973. Ndodhet në Dhuvjan, në qarkun e Gjirokastrës. Në kuadër të projektit të restaurimit, janë menduar të bëhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Restaurim i çatisë me rrasa guri;
- Rinovim i portës hyrëse prej druri;
- Konsolidim strukturor i konakut të parahyrjes;
- Rindërtim i çatisë;
- Rindërtim i kolonave prej guri;
- Rindërtim i mureve të konakut;
- Stabilizim i muraturave;
- Punime hidroizolimi dhe çatie;
- Restaurim dyer druri;
- Pajatim i muraturës së dëmtuar me elementë druri;
- Pastrim i manastirit nga papastërtitë dhe depozitimet.




PROJEKTE RESTAURIMI

Monument Kulture i Kategorisë së parë (I). U krijua në vitin 1985. Në të janë ekspozuar pasuritë arkeologjike të trevave juglindore të Shqipërisë, ku vendin kryesor e zë pellgu i Korçës.

Në kuadër të projektit për restaurimin e muzeut, do kryhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Ndërhyrje përforcuese në themelet e ndërtesës dhe në muraturë;
- Restaurim i çatisë në tërësinë e elementeve të saj konstruktivë;
- Restaurim i muraturës prej guri;
- Restaurim i ndërkateve;
- Restaurim i elementëve drusorë në interior.




Ish banesa e Toptanasve/Libohovitëve, gëzon statusin Monument Kulture të Kategorisë së parë (I), datë 10.06.1973. Në kuadër të projektit “Projektimi, Restaurimi dhe Muzealizimi i ish banesës së Toptanasve/Libohovitëve (Muzeu Besa)”, u zhvilluan sondazhet arkeologjike për njohjen sa më të mirë të potencialit arkeologjik nëntokësor të zonës së propozuar për krijimin e “Muzeut Besa”.

- Koncepti për muzeun e ri të Besës sillet rreth krijimit të hapësirave të grumbullimit brenda zonës, e cila pasqyron hapësirat tradicionale duke u lidhur gjithmonë me to.
- Muzeu i ri i Besës kuptohet si mishërim i koncepteve të Besës, është një hapësirë ftuese, që sinjalizon praninë e tij në qytet me fenerët e kullave dhe fton të gjithë në hapësira mikpritëse grumbullimi përmes të cilave mund të pushojnë dhe të mësojnë më shumë rreth rrugës Besa duke u zhytur në të.



PROJEKTE RESTAURIMI





Kalaja e Kaninës, Monument Kulture i Kategorisë së parë (I), ndodhet në qarkun e Vlorës. Mendohet të jetë ngritur rreth shek. IV p.e.s.

Në kuadër të projektit për restaurimin e kalasë, do kryhen ndërhyrjet si më poshtë:

- Studim i detajuar i gjendjes së konservimit të strukturave të kalasë nëpërmjet studimeve dhe vlerësimeve gjeologjike, hidrologjike, strukturore;
- Ndërhyrje konsoliduese nëpërmjet vendosjes së barrierave të sigurisë, stabilizimit të tokës, mbështetjes së bazës së shpatit dhe ankerave shkëmborë, etj.;
- Ndërhyrje konservuese dhe restauruese të strukturave të kalasë;
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për interpretimin e sitit dhe përmirësimin e eksperiencës së vizitorëve, dhe krijimi i një amfiteatri.

Kalaja e Borshit, Monument Kulture i Kategorisë së parë (I), ndodhet mbi një kodër të fshatit Borsh, 500 m mbi nivelin e detit dhe daton rreth shek. IV-III p.e.s. Në kuadër të projektit për restaurimin e kalasë, do kryhen ndërhyrjet si më poshtë:


- Ndërhyrje restauruese dhe konservuese të strukturave të kalasë (muret veriore, jugore);
- Ndërhyrje konsoliduese, konservuese dhe restauruese të strukturës së xhamisë (përforcim i kupolës, restaurim i mureve perimentalë, dyshemesë, etj.) me metodat e përforcimit, injektimit, fugatimit, qepje të çarjeve;
- Stabilizim gjeologjik dhe vendosje e stacioneve gjeologjike mekanike;
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për interpretimin e sitit dhe përmirësimin e eksperiencës së vizitorëve.



PROJEKTE KËRKIMORE-SHKENCORE NË VAZHDIM

Kaonia bregdetare: kërkime arkeologjike në Foinike-Butrint 2024

- Vijimi i gërmimeve në tarracën në jug të Agorasë helenistike, si dhe në zonën midis teatrit dhe Agorasë;
- Gërmime në zonën e nekropolit jugor;
- Survejime topografike dhe fotogrametrike (me dron) të territorit rreth Foinikës.




Apollonia e Ilirisë

- Vijimi i prospeksioneve elektro-magnetike, të cilët u përqendruan kryesisht në zonën veri-perëndimore dhe jugore të hapësirës intra-muros. Ky operacion synon krijimin hartës së plotë të anomalive që dokumentohen në zonën urbane të Apolonisë.
- Vijimi i studimit me qëllim përgatitjen e monografive të parashikuara në marrëveshjen ndër-institucionale.



PROJEKTE KËRKIMORE-SHKENCORE NË VAZHDIM



Kontekstualizimi i Neolitit në fushën e Korçës

- Ky projekt synon të përcaktojë madhësinë dhe strukturat e vendbanimeve neolitike në fushën e Korçës, si dhe raportin që kanë këto vendbanime me peizazhin nëpërmjet studimit gjeofizik dhe kërkimeve sipërfaqësore.
- Ky do të jetë studimi i parë gjeofizik sistematik i vendbanimeve neolitike në Shqipëri dhe projekti i parë që do të studiojë në mënyrë specifike madhësinë dhe strukturën e vendbanimeve të kësaj periudhe.

Sistemi fortifikues antiko-mesjetar i Durrësit

- Pamundësia e identifikimit të gjurmëve të linjës lindore të rrethimit të madh të periudhës romake të vonë, gjatë sezonit 2022-2023, e lë të hapur nevojën e kërkimit të shtrirjes ose jo të murit rrethues në anën lindore.
- Është me interes njohja e stratigrafisë në këtë pjesë të qytetit, pranë murit rrethues të periudhës mesjetare/osmane.

